



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

г./v. \_\_\_\_\_



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 8150/1 të datës 12.09.2022, me pretendime kundër drejtorit-----  
Shkup, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka autoritet të veprojë sepse denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, pa specifikuar persona dhe aktivitete të veçanta, dhe se pretendimet në denoncim i referohen shkeljes së një të drejte individuale të parashtruesit për të cilën KSHPK-ja nuk ka autoritet të veprojë.

Lënda me numër 12 - 8150/1 nga data 12.09.2022 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Me datë 12.09.2022 është parashtruar denoncim nga një parashtrues i njohur, sipas të cilit lënda numër 12 - 8150/1 e datës 12.09.2022 është parashtruar me pretendime për korrupsion ndaj drejtorit të -----  
---Shkup, për mos. - leje për të parë fëmijët.

Denoncimi i dorëzuar përmban pretendime të përgjithshme që janë plotësisht të paqarta dhe ato paraqesin revoltën dhe pakënaqësinë e parashtruesit me sjelljen e institucioneve në RMV-së dhe në lidhje me shkeljen e të drejtës së tij individuale si prind që nuk është lejuar të takohet me fëmijët e tij, gjë që ai dyshon për veprimet e drejtoreshës së ----- Shkup, -----.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të raportuara, KSHPK-ja konstatoi se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, pa specifikuar persona dhe aktivitete të veçanta, dhe nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare. dhe pretendimet e denoncuar i referohen shkeljes së të drejtës individuale të parashtruesit, për të cilën KSHPK-ja nuk ka kompetencë të veprojë. Gjithashtu për rastin në fjalë është zhvilluar procedura gjyqësore dhe penale pranë organeve të tjera kompetente që janë kompetente për të vepruar në fushën lëndore. Nga aty KSHPK-ja konsideroi se nuk ka kompetencë të veprojë në rastin në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETЃOROR  
PЃR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
NЃNKRYETARE,  
Katica Nikolovska**

DorЃzuar: parashtruesi i denoncimit  
pЃrgatiti: J.C.  
Miratoi:S.P.D , anЃtar i KSHPK-sЃ

